



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 235 Akti**

**Nr. 255 Vendimi**

**Tiranë, më 8.6.2020**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, më 4.6.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ludovik Dodaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik M. Dodaj, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Suela Zhegu dhe znj. Alma Faskaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja znj. Genta Tafa (Bungo).

**4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.11.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj.

**5** Me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos rishpërndarja e çështjeve të shortuara në datën 15.11.2018 me anëtare trupi gjykues znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës së komisioneres për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur po atë mbledhje, anëtar zëvendësues për këtë subjekt u zgjodh z. Olsi Komici, i cili deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

**6.** Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

**7** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

**8.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse

subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**9.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**10.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**11.** Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

**12.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Ludovik Dodaj.

**13.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.05.2018.

<sup>2</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 11.9.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2019.

**15.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 28.2.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, si dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t' u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**16.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 2.3.2020, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 6.3.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 8.3.2020.

**17.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**18.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 1.6.2020.

**19.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 4.6.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Ferdinando Buatier de Mongeot.

**20.** Subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, Ludovik Dodaj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**21.** Z. Ludovik Dodaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**21.1** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**22.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

---

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 1.6.2020.

**23.** Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>5</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**24.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore.

## **VLERËSIMI I PASURISË**

**25.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

*Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:*

**26. Apartament banimi<sup>6</sup> 2+1 me sipërfaqe totale 108.48 m<sup>2</sup>; (i) vlera e deklaruar 45.000 euro; (ii) pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten; (iii) Subjekti ka deklaruar se e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.9.2006; kaluar pronësia më 5.10.2013 me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.**

**26.1 Burimi i deklaruar i pasurisë: (i) shuma prej 2 500 euro e paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes është marrë nga kontrata e shitblerjes së shtëpisë**

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

<sup>6</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*; (ii) Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2013; (iii) Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.9.2006; (iv) Kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.12.2006, kredihënëse “Banka Kombëtare Tregtare”; (v) Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.2003; (vi) Vërtetim pronësie e lëshuar nga Zyra e Hipotekës Shkodër, datë 28.1.1994, i apartamentit me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup> në lagjen “\*\*\*\*”, Shkodër.

në Shkodër, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.2003. Vlera e shtëpisë në Shkodër është 1.900.000 lekë. Përveç kësaj shume, nga shtëpia e Shkodrës është përfituar dhe shuma 300.000 lekë nga shitja e pajisjeve të shtëpisë. Gjithashtu kësaj shume i janë shtuar edhe kursimet ndër vite deri në 2006; **(ii)** Më datë 18.12.2006 është marrë kredi tek “BKT”, në shumën 1.200.000 lekë; qëllimi “pajisje të shtëpisë dhe pagesa e këstit të parë sipas kontratës së sipërmarrjes në shumën 7.000 euro është bërë në 2007”; **(iii)** Në vitin 2008 është paguar kësti tjetër i shtëpisë në shumën 4.000 euro nga kursimet e familjes; **(iv)** Në vitin 2009 kam paguar 4.000 euro, këstin e radhës për shtëpinë. Shumën e marrë nga huaja e siguruar nga kunati im (vëllai i bashkëshortes) 8.000 euro; **(v)** Në vitin 2012 shlyer kësti i fundit 5.000 euro, nga kursimet; **(vi)** Në vitin 2013 paguar tatimi mbi kalimin e pronësisë për apartamentin në shumën 117.000 lekë.

### **🚩 Hetimi<sup>7</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri**

**26.2** Nga hetimi rezulton se më 1.9.2006, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\* midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nëpërmjet së cilës është porositur apartament me sipërfaqe ndërtimi 119.48 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e brendshme 108.48 m<sup>2</sup> + sipërfaqe e ambientit të përbashkët 11 m<sup>2</sup>).

**26.3** Çmimi i sipërmarrjes bazuar në kontratën e sipërmarrjes është caktuar 45.140 euro dhe do të paguhej si më poshtë:

- 15 000 euro janë paguar nga porositësi dhe janë marrë në dorëzim nga sipërmarrësi;
- 10 000 euro do të pagohen brenda muajit gusht;
- 5 000 euro janar 2007;
- 5 000 euro qershor 2007;
- 10 140 euro dhjetor 2007

**26.4** Në lidhje me shlyerjen e këtyre pagesave, subjekti, në deklaratën “Vetting” deklaroi si më poshtë:

- 25 000 euro me nënshkrimin e kontratës; ky deklaram është bërë dhe në DVP/2006;
- 7 000 euro në vitin 2007; ky deklaram është bërë dhe në DVP/2007<sup>8</sup>;
- 4 000 euro në vitin 2008; ky deklaram është bërë dhe në DVP/2008<sup>9</sup>;
- 4 000 euro në vitin 2009; ky deklaram është bërë dhe në DVP/2009<sup>10</sup>;
- 5 000 euro në vitin 2012; ky deklaram është bërë dhe në DVP/2012<sup>11</sup>;

**26.5** Gjatë hetimit subjekti depozitoi dokumentacion provues<sup>12</sup>, duke provuar se pagesat e këtij apartamenti janë bërë sipas deklarimeve të tij në deklaratat periodike dhe në deklaratën “Vetting”.

**26.6** Në datë 5.10.2013 është lidhur kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 5.10.2013 midis bashkëshortes së subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k për blerjen e këtij apartamenti.

**26.7** Nga ana e ZVRPP-së Durrës konfirmohet fakti se në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij është apartamenti me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, me adresë: lagjja nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës, kati i gjashtë, shkalla \*\*\*, me sipërfaqe 108.48 m<sup>2</sup>.

<sup>7</sup> Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Bankave; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

<sup>8</sup> Detyrim i mbetur sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 1.9.2006 për shtëpi banimi në shumën 20 000 euro. Shlyer 7 000 euro mbetur 13 000 euro.

<sup>9</sup> Detyrim për shtëpi banimi sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.9.2006 e deklaruar në 2007. Shlyer 4 000 euro mbetur 9 000 euro.

<sup>10</sup> Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.9.2006 e deklaruar në 2007. Shlyer 4 000 euro mbetur 5 000 euro.

<sup>11</sup> Shlyer detyrimi sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.9.2006.

<sup>12</sup> Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 17.12.2019.

## **🚩 Hetimi/analiza ligjore-financiare për burimin e krijimit të pasurisë së llojit “apartament”:**

**26.8** Referuar deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, **subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë “apartament”, si më poshtë:**

- i. Vlera e shtëpisë në Shkodër është 1.900.000 lekë. Përveç kësaj shume nga shtëpia e Shkodrës është përfituar dhe shuma 300.000 lekë nga shitja e pajisjeve të shtëpisë. Gjithashtu kësaj shume i janë shtuar edhe kursimet ndër vite deri në 2006;
- ii. Kredi tek “BKT”, në shumën 1.200.000 lekë;
- iii. Hua nga kunati;
- iv. Në vitin 2008 është paguar kësti tjetër i shtëpisë në shumën 4.000 euro nga kursimet e familjes;
- v. Në vitin 2012 shlyer kësti i fundit 5.000 euro, nga kursimet;

**26.9** Në datë 5.6.2003, me kontratë nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit së bashku me familjarët e tij kanë shitur një apartament banimi në qytetin e Shkodrës, me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, për shumën 1,900,000 lekë<sup>13</sup>. Subjekti ka deklaruar se ka përfituar një shumë prej 300,000 lekë nga shitja e mobilieve të këtij apartamenti, por pa dorëzuar dokumentacion provues. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar shkresa të thjeshta për të provuar shitjen e mobilieve. Komisioni vlerëson se pavarësisht njohjes apo jo të shumës 300,000 lekë (si e ardhur nga shitja e mobiljeve), subjekti i rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 2,200,000 lekë të deklaruar në DVP/2003.

**26.10** Në datën 18.12.2006 me kontratë kredie nr. \*\*\*, subjekti ka marrë kredi nga “BKT”-ja në shumën 1 200 000 lekë, me afat 60 muaj.

**26.11** Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “BKT” rezulton se:

- i. Në datën 21.12.2006 është disbursuar shuma 1 176 000 lekë;
- ii. Në datën 22.12.2006 është tërhequr shuma 1 147 000 lekë;
- iii. Në datën 3.2.2009 z. P. D., ka derdhur shumën 840 732 lekë për mbyllje kredie;
- iv. Në datën 3.2.2009 është shlyer kredia në shumën 805 551.24 lekë;
- v. Në datën 5.2.2009 z. P. D., ka depozituar shumën 6 700 lekë.

Në lidhje me dy depozitimet e kryera nga z. P. D., subjekti sqaron se: *“P. D., është vëllai im i cili ka qenë me banim në Durrës. Shuma prej 840 732 lekë buron nga kontrata e huas që kam bërë me kunatin tim z. A. D., në shumën 8000 euro, pikërisht për të shlyer këtë kredi. Prandaj nuk janë para të z. P. D., por ia kam dhënë unë të shlyejë pjesën e mbetur të kredisë, për të mos humbur kohë nga puna ime. Pra, vëllai im është paraqitur për llogari timen dhe nuk ka depozituar para nga pasuria e tij për mua. Ndërsa shuma 6700 lekë sërish është e ardhur e imja për të paguar sigurimin e pronës dhe jetës sipas detyrimit që na kërkonte banka. Edhe këto para theksoj se nuk janë të z. P. D., por ky i fundit po kryente vetëm shërbimin për të bërë pagesën në llogari timen dhe derdhjet janë para të miat.”*

Bazuar në shpjegimet e subjektit shumat e depozituara nga z. P. D., janë përfshirë në analizë financiare si shpenzime të subjektit. Nga analiza financiare subjekti rezulton me bilanc pozitiv edhe pas përfshirjes së këtyre shpenzimeve në analizë financiare.

**26.12** Në lidhje me huan e marrë nga kunati, subjekti në deklaratën “Vetting” deklaroi:

---

<sup>13</sup> Në DVP 2003 subjekti deklaroi se ka gjendje cash në banesë shumën 2 200 000 lekë me burim shitjen e shtëpisë në Shkodër.

“Kontratë huaje me kunatin tim z. A. D., në shumën 8.000 euro e marrë në vitin 2009 për të shlyer kredinë e vitit 2006. Kontrata është lidhur verbalisht pa ndonjë formë të caktuar sipas ligjit duke qenë se ishim në marrëdhëniet e mirëbesimit. Z. A. D., jeton në shtetin e Greqisë që prej vitit 1994 me familjen, me rezidencë aktuale në Verio dhe me të ardhura nga të dy bashkëshortët. Informacioni për këtë person në lidhje me të ardhurat dhe banimin është depozituar pranë ILDKPKI me datë 8 Prill 2016.”

**26.13** Subjekti për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave të huadhënësit ka depozituar dokumentet “shënim për likuidimin e taksës mbi të ardhurat personave fizik në bazë të deklaramit fillestar” të z. A. D., për periudhën 2005-2014. Bazuar në këtë dokumentacion rezulton se kunati i subjektit për periudhën 2005-2009 ka krijuar të ardhura në shumën **54 413 euro**, të cilat janë të mjaftueshme për dhënien e huas 8 000 euro.

**26.14** Shlyerja e huas bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike është kryer si më poshtë:

- i. 3 000 euro në vitin 2010;
- ii. 3 000 euro në vitin 2011;
- iii. 2 000 euro në vitin 2013;

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj huaje.

**26.15** Nga analiza financiare e kryer për vitet 2006-2012 pasqyruar në tabelën e mëposhtme subjekti rezulton me mungesë mjetesh financiare në shumën 358 816 lekë për vitin 2008. Për këtë subjektin iu kërkuan shpjegime në përfundim të hetimit.

	2006	2007	2008	2009	2012
<b>PASURI</b>	<b>870 186</b>	<b>794 653</b>	<b>1 238 342</b>	<b>816 597</b>	<b>803 160</b>
Apartament banimi 2+1, ***, Durrës	3 092 575	846 370	492 730	548 680	698 600
Shtesa/Pakësime likuiditete	-2 222 389	-51 717	745 612	267 917	104 560
Likuiditete gjendje	52 266	549	746 160	1 014 077	2 162 776
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>2 671 903</b>	<b>1 543 156</b>	<b>1 758 612</b>	<b>3 130 737</b>	<b>2 419 492</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 117 941	1 173 866	1 272 652	1 413 332	1 465 797
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	336 000	357 250	385 760	424 944	528 000
Të ardhura nga paga e djalit		9 600	100 200	171 300	93 000
Të ardhura nga paga e vajzës	9 478	2 440	0	23 802	332 695
Kredi në “BKT” me objekt “Rikonstruksion Shtëpie”	1 200 000				
Hua nga kunati 8,000 euro që jeton në Greqi				1 097 360	
Interesa bankare	8 484				
<b>SHPENZIME</b>	<b>794 951</b>	<b>949 573</b>	<b>879 086</b>	<b>1 420 579</b>	<b>916 365</b>
Shpenzime jetese	438 228	546 480	546 480	546 480	558 192
Shpenzime udhëtimi TIMS	3 093	129 470	20 192	0	304 660
Paguar kredia tek “BKT” 1,200,000 lek		273 623	312 414	840 356	
Paguar kredia tek “RZB” (për blerje TV)					53 512
Shpenzime/komisione të kredisë	52 844			33 743	
Shpenzime mobilimi	300 630				
<b>Mundesia për kursime</b>	<b>106 766</b>	<b>698 931</b>	<b>-358 816</b>	<b>893 562</b>	<b>699 967</b>

Subjekti dhe shpjegimet e tij në lidhje me këtë balancë negative. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, çmon se nisur nga vlera e këtyre shpenzimeve, duke arsyetuar mbi bazën



e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre shpenzimeve të pambuluara, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se balanca negative në vitin 2008, nuk mund të shërbejë si shkak i vetëm për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61.

**27. Automjet “Benz C Class 200”<sup>14</sup>**, viti i prodhimi 2010, i blerë në shtetin e Gjermanisë me anë të kontratës së shitblerjes në nëntor 2013. Mbi këtë automjet është paguar dogana në vlerën 392.421 lekë. Vlera 9.500 euro. Pjesa takuese 100%.

**27.1 Burimi i deklaruar i pasurisë:** (i) për blerjen e këtij automjeti është marrë një kredi në “Raiffeisen Bank” më 22.11.2013, në shumën 1.008.800 lekë; (ii) një pjesë është përfituar nga kontrata e shitblerjes së makinës së mëparshme “Benz 190” e prodhimit në vitin 1989 me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., e datës 18.10.2013, me çmimin 180.000 lekë; (iii) pjesa tjetër e pagesës së makinës është bërë nga kursimet.

**🚦 Hetimi<sup>15</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri:**

**27.2** Subjekti i rivlerësimit në datën 26.11.2013, bazuar në faturën e shoqërisë “\*\*\*\*” ka blerë automjetin tip “Mercedes - Benz C200” për shumën 9 500 euro.

Për këtë automjet referuar deklaratës doganore “Import 4” të datës 6.12.2013 është paguar detyrimi doganor në shumën 392,421 lekë<sup>16</sup>.

**27.3** Si burim për blerjen e këtij mjeti subjekti ka deklaruar:

*i. Kredi në “Raiffeisen Bank” më 22.11.2013 në shumën 1.008.800 lekë.*

Në datën 22.11.2013 subjekti ka marrë kredi pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 1 008 800 lekë me afat 60 muaj. Nga nxjerrja e llogarisë e subjektit në lekë në “Raiffeisen Bank” rezulton se:

- Kredia është disbursuar në datën 22.11.2013. Në po të njëjtën datë subjekti ka tërhequr shumën 984 000 lekë.
- Subjekti, në datën 5.6.2014 ka likuiduar pjesërisht këtë kredi, duke paguar shumën 637 793 lekë. Kjo shumë është krijuar nga gjendja në llogari dhe një depozitim *cash* në shumën 430 000 lekë. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për likuidimin e kredisë në vitin 2014.
- ii. Një pjesë është përfituar nga kontrata e shitblerjes së makinës së mëparshme “Benz 190” e prodhimit në vitin 1989 me kontratën nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., e datës 18.10.2013 me çmimin 180.000 lekë.*

Në datë 18.10.2013 me kontratë nr. \*\*\*, subjekti ka shitur mjetin “Mercedes - Benz 190D” \*\*\* për shumën 180 000 lekë. Ky mjet është blerë nga subjekti me datë 13.10.2004 me kontratë nr. \*\*\* për shumën 200 000 lekë.

*iii. Pjesa tjetër e pagesës së makinës është bërë nga kursimet.*

**27.4** Nga analiza financiare konstatohet se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

<sup>14</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) *Certifikatën e pronësisë së automjetit “Mercedes Benz 204, C200 CDI”, targa \*\*\* në emër të Ludovik Dodaj, lëshuar më datë 11.12.2013;* (ii) *Faturën e blerjes së automjetit në Gjermani pranë kompanisë “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, datë 26.11.2013;* (iii) *Deklaratën e zhdoganimit të automjetit;* (iv) *Kontratë shitje automjeti “Benz 190”, me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 18.10.2013;* (v) *Kontrata e blerjes së automjetit “Benz 190”, nr. \*\*\* rep./nr.\*\*\* kol., datë 13.10.2004;* (vi) *Kontratë kredi bankare, nënshkruar në datë 22.11.2013, midis palëve “Raiffeisen Bank” dhe Ludovik Dodaj.*

<sup>15</sup> Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Bankave; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; Shkresë nr. \*\*\* datë 8.11.2019 drejtuar noterit Publik K. H.

<sup>16</sup> Në DVP/2013 deklaroi 2 800 euro shpenzime doganore.

**27.5** Nuk kanë rezultuar dyshime apo pamjaftueshmëri mjetesh financiare në lidhje me këtë pasuri të subjektit.

**28. Subjekti<sup>17</sup> ka deklaruar pronësinë mbi:**

- Tokë arë, me sipërfaqe 630 m<sup>2</sup>, e ndodhur në \*\*\*, Mirditë. Pjesa takuese 100%.
- Tokë arë, me sipërfaqe 620 m<sup>2</sup>, e ndodhur në \*\*\*, Mirditë. Pjesa takuese 100%.

**28.1 Burimi i deklaruar i të dyja pasurive:** Jam bërë pronar i kësaj pasurie me anë të kontratës së dhurimit me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2013, nga ana e vëllait tim P. D. Ky dhurim është bërë me qëllim të shpërblimit ndaj meje për angazhimin dhe përkujdesjen e prindërve në gjallërinë e tyre.

**🚩 Hetimi<sup>18</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këto pasuri:**

**28.2** Subjekti i rivlerësimit me kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 11.10.2013 ka përfituar nga vëllai i tij pasurinë “arë”, me sipërfaqe 630 m<sup>2</sup>, me numër pasurie. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\* dhe pasurinë me sipërfaqe 620 m<sup>2</sup>, me numër pasurie, \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, të regjistruara në \*\*\*, Mirditë. Këto pasuri konfirmohen dhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2017 e ZVRPP-së Mirditë, administruar nga ana e ILDKPI-së.

**28.3** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këto pasuri.

**DEKLARIMI I VAJZËS SË SUBJEKTIT – B. D. – DEKLARIMI I PASURIVE**

**29. Shtëpi banimi<sup>19</sup>**, apartament, me sipërfaqe 88.50 m<sup>2</sup>, ndodhur në Yzberisht, Tiranë. (i) vlera e deklaruar 40.000 euro. (ii) pjesa takuese në bashkëpronësi me bashkëjetuesin, z. E. D.

**29.1 Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** Kjo shtëpi është blerë nga të ardhurat të marra me kredi me kontratën e kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.4.2016, për shumën 4.500.000 lekë. Për blerjen e kësaj shtëpie është paguar edhe një kapar paraprak me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.12.2015, në shumën 5.000 euro, shumë e cila është paguar nga ana e bashkëjetuesit tim z. E. D. Ndërkohë, për rimbursimin e kredisë kërkohej edhe ngrirja e 3.000 euro në bankë për të plotësuar vlerën e plotë të shtëpisë, shumë kjo e paguar nga bashkëjetuesi im.

<sup>17</sup> **Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:** (i) Kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2013; (ii) Certifikatë pronësie të pasurisë nr. \*\*\*, në emër të P. D., lëshuar më 1.10.2013 për arë me sipërfaqe. 630 m<sup>2</sup>, plus kartelë e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit; (iii) Certifikatë pronësie të pasurisë nr. \*\*\*, në emër të P. D., lëshuar më datë 1.10.2013 për arë me sipërfaqe. 620 m<sup>2</sup>, plus kartelë e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit; (iv) Certifikatë e pronësisë të pasurisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 22.10.2013, në emër të Ludovik Dodaj për arë me sipërfaqe 630 m<sup>2</sup>, shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit; (v) Certifikatë e pronësisë të pasurisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 22.10.2013, në emër të Ludovik Dodaj, shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit.

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 8.11.2019 drejtuar noterit publik K. H.; Kthim përgjigje noteri publik K. H., datë 18.11.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

<sup>19</sup> **Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:** (i) Kontratë kapari (për premtim, shitje të pasurisë së llojit “apartament”), nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.12.2015; (ii) Kontratë shitblerjeje me kusht kreditimi, pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.2.2016; (iii) Kontratë kredie bankare afatgjatë, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.4.2016, nënshkruar midis “Bankës Societe Generale Albania” dhe kredimarrësve E. D., dhe B.D. Vlera e kredisë 4.500.000 lekë, me qëllim “blerje apartamenti”. Afat shlyerjeje 240 muaj; (iv) Kontratë hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.4.2016, në të cilën garantohet shlyerja e marrjes së kredisë; (v) Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë “Apartament” me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, në emër të B. D., dhe E. D., lëshuar më datë 27.4.2016; (vi) Kartela e pasurisë së paluajtshme së apartamentit të regjistruar më datë 27.4.2016, me kontratë shitje me kusht+deklaratë noteriale.

## **🚩 Hetimi<sup>20</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri:**

**29.2** Në datën 2.12.2015 është lidhur kontratë kapari (për premtim, shitje të pasurisë së llojit “apartament”) nr. \*\*\*, datë 2.12.2015, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, kundrejt vlerës 40.000 euro. Në kontratë përcaktohet se z. E. D., do të paguajë paraprakisht shumën 5.000 euro në llogarinë e noteres, ndërsa diferenca 35.000 euro do të paguhet nëpërmjet kredisë që premtuesit për blerje do të përfitojnë nga një prej bankave të nivelit të dytë. Pagesa e kaparit në shumën 5 000 euro si dhe ngurtësimi i një shume prej 3 000 euro në llogarinë e noterit, që ka hartuar kontratën e kaparit konfirmohet nga ana e “BKT”-së.

**29.3** Në datë 9.2.2016 me kontratë shitblerje me kusht kreditimi pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* është blerë apartamenti i mësipërm.

**29.4** Vajza e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj me kontratë kredie bankare afatgjatë, nr. \*\*\* datë 30.4.2016, kanë marrë kredi pranë bankës “Societe Generale Albania” në shumën 4.500.000 lekë, me qëllim “blerje apartamenti”. Afati shlyerjes 240 muaj.

**29.5** Për garantimin e kësaj kredie është lidhur kontratë hipoteke nr. \*\*\* kol., datë 30.4.2016, nëpërmjet së cilës vendoset në hipotekë pasuria “apartament” regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>, në emër të E. D., dhe B. D., blerë më kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*.

**29.6** Bazuar në nxjerrjen e llogarisë të z. E. D., në bankën “Societe Generale Albania” është bërë disbursimi i kredisë në shumën 4 500 000 lekë. Në datë 18.5.2016 është transferuar shuma 4 435 200 lekë me emërtim “*Likuidim përfundimtar për blerje apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\**” në llogarinë e noterit publik që ka hartuar kontratën e shitblerjes.

**29.7** Kalimi i pasurisë tek z. E. D., dhe znj. B. D., është bërë bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.3.2016 të pronarëve të apartamentit, të cilët deklarojnë se janë dakord që të bëhet kalimi i pronësisë në favor të palës blerëse me kushtin që kjo pronë të qëndrojë e bllokuar në favor të tyre.

**29.8** Pagesa e shumës 35 000 euro vërtetohet me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 20.5.2016, ku shitësit e apartamentit deklarojnë se z. E. D., dhe znj. B. D., kanë përmbushur kushtin, duke paguar në llogarinë e noteres këstin e dytë në shumën 35 000 euro.

**29.9** Nga analiza financiare rezulton se vajza e subjektit dhe bashkëjetuesi i saj kanë patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.

**29.10** Nuk rezultojnë paqartësi apo dyshime për këtë pasuri.

**30.** Nga hetimi ka rezultuar se më 23.6.2016, me kontratë nr. \*\*\*, vajza e subjektit ka shitur makinën tip “Volkswagen Golf” për shumën 6.000 euro.

---

<sup>20</sup> Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Bankave; Kthim përgjigje Societe Generale Albania Bank nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2019; Kthim Përgjigje BKT nr. \*\*\* prot., datë 28.01.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit; Kthim Përgjigje QKB nr. \*\*\* prot., datë 15.01.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; Kthim Përgjigje DPT nr. \*\*\* prot., datë 10.01.2019; Shkresë e DPT drejtuar DRT Tiranë për dijeni KPK nr. \*\*\* prot., datë 10.01.2019; Kthim Përgjigje DRT Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 28.01.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; Kthim Përgjigje ZVRPP Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 21.01.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; Kthim përgjigje DPSHTRR nr. \*\*\* prot., datë 04.01.2019; Kthim Përgjigje DPSHTRR nr. \*\*\* prot., datë 17.01.2019; Shkresë nr. \*\*\* datë 08.11.2019 drejtuar noterit publik M. V.; Kthim përgjigje noterit publik M. V., nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2019.

**30.1** Ky automjet është blerë në datën 25.6.2015 me kontratën nr. \*\*\* për shumën 4 400 euro. Si burim për blerjen e këtij automjeti vajza e subjektit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar: *Për blerjen e makinës “Volkswagen Golf 5”, e vitit 2008, në qershor të vitit 2015 kam marrë hua shumën 5.000 euro nga kushërira ime znj. E. K., shumë të cilën ia kam kthyer me marrjen e parave nga kontrata e shitjes së automjetit në qershor të vitit 2016.*

**30.2** Marrja e huas provohet me kontratën e huas të datës 15.6.2015 lidhur midis znj. E. K., në cilësinë e huadhënëses dhe znj. B. D., në cilësinë e huamarrëses. Afati i huas është përcaktuar 3 vjet.

**30.3** Kjo hua është kthyer nga vajza e subjektit në datën 20.7.2016, bazuar në deklaratën e thjeshtë të znj. E. K.

**30.4** Në lidhje me të ardhurat e znj. K., nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

(i) Bazuar në shkresën e QKB -së rezulton se znj. E. K., figuron e regjistruar si person fizik nga data 3.3.2016 me NIPT \*\*\*. Referuar ekstraktit historik të regjistrimit tregtar ajo ushtron aktivitetin e avokatit.

(ii) Bazuar në shkresën e “BKT”-së rezulton se znj. K., ka patur një depozitë në shumën 30 000 euro së bashku me z. A. K. Shuma 30 000 euro është tërhequr në datë 21.10.2011.

**30.5** Subjekti në lidhje me burimin e huasë 5 000 euro dhënë vajzës të tij sqaron se: *“Znj. E. K., ka qenë e martuar me shtetasin A. K. Shuma është nga shitja e pasurive të paluajtshme nga ata të dy, konkretisht kontrata me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 7.5.2013 çmimi 5.960.000 lekë.”* Subjekti ka vënë në dispozicion kontratë shitje apartamenti nr. \*\*\*, të datës 7.5.2013 nga ku rezulton se znj. K., dhe bashkëshorti i saj kanë shitur një apartament për shumën 5, 960, 000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti si dhe nga hetimi administrativ rezulton se znj. K., ka patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 5, 000 euro.

**30.6** Në përfundim rezulton se vajza e subjektit ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Volkswagen”.

## **DEKLARIMI I DJALIT TË SUBJEKTIT – B. D., DEKLARIMI I PASURIVE**

**31. Automjet**<sup>21</sup> i llojit autoveturë, tipi “Benz B Class” e prodhimit 10.10.2006, e blerë nga bashkëshortja (sot) znj. S. D. (i) Vlera e deklaruar 12.185 euro. (ii) Pjesa takuese 30%.

**31.1 Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** Ky kalim është bërë me deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.11.2010, duke i dhuruar bashkëshortit B. D., 30% të pjesës së automjetit. Ky dhurim është bërë në shërbim të përdorimit të përbashkët në mënyrë që të shmangnim pengesat në qarkullim. Çmimi i blerjes ka qenë 12.185 euro. Pjesa takuese më është dhuruar nga bashkëshortja.

### **Hetimi**<sup>22</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri:

<sup>21</sup> **Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:** (i) Deklaratë noteriale për bashkëpronësi automjeti nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol., datë 22.11.2010; (ii) Çertifikata e pronësisë së automjetit me targa \*\*\*.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Bankave; Kthim përgjigjeje “Credins Bank” nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2019; Kthim përgjigjeje “BKT” nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018; Kthim përgjigjeje QKB nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019; Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; Kthim përgjigjeje DPT nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019; Shkresë e DPT-së drejtuar DRT-së Durrës për dijëni KPK-së nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019; Shkresë e DPT-së drejtuar DRT-së Tiranë për dijëni KPK-së nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019; Kthim përgjigjeje DRT-ja Durrës nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2019; Kthim përgjigjeje DRT-ja Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; Kthim Përgjigjeje ZVRPP-ja Tiranë

**31.2** Znj. S. D. (R.) bazuar në deklaratën noteriale për bashkëpronësi automjeti nr. \*\*\* kol., datë 22.11.2010, deklaroi se ka blerë automjetin “Mercedes – Benz” dhe kërkon që regjistrimi i mjetit të jetë në bashkëpronësi me B. D., me të drejta dhe detyrime në masën 70% deklaruesja dhe 30% B. D.

**31.3** Nga dokumentacioni i administruar nga ana e DPSHTRR-së rezultoi se automjeti është blerë për shumën 9 400 euro dhe janë paguar detyrime doganore në shumën 384 422 lekë.

**31.4** Ky automjet është shitur në datën 16.8.2018 me kontratë nr. \*\*\* për shumën 3500 euro.

**32.** Në deklaratën “Vetting”, djali i subjektit ka deklaruar si detyrim kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 12.8.2016 me afat 5-vjeçar, 60 muaj. Kredidhënës “Banka Credins” sh.a dhe kredimarrës B. D. Shuma e marrë kredi është 1.000.000 lekë, me qëllim “mobilim banese”.

**32.1** Nga nxjerrja e llogarisë në “Credins Bank” e z. B. D., rezultoi se:

- Kredia është disbursuar në datë 12.8.2016 dhe është tërhequr *cash* në të njëjtën datë.
- Në datë 6.2.2017 është depozituar shuma 950 000 lekë, e cila ka shërbyer për shlyerjen e kredisë.

**32.2** Në DVP/2017 djali i subjektit deklaroi se kredia është shlyer me të ardhurat e siguruara nga shitja e truallit në Rrugën e Elbasanit, fakt i cili konfirmohet dhe nga nxjerrja e llogarisë së znj. S. R., në “BKT” (shih pikën 33).

**32.3** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

**33.** Znj. S. R., bashkëshortja e djalit të subjektit, së bashku me motrën dhe nënën e saj, me kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme (truall) nr. \*\*\*, datë 19.12.2016, kanë shitur tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë “truall” me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, ndodhur në Rrugën e Elbasanit, Tiranë, sipërfaqe totale 350 m<sup>2</sup>. Vlera totale e shitjes së truallit në shumën 87.000 euro. Bazuar në nenin 4 të kontratës parashikohet se shuma e blerjes do të kalojë në llogarinë e znj. S. R. Ky truall bazuar në kartelën e pasurisë e ka origjinën nga dëshmia e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 9.1.2015.

**33.1** Nga nxjerrja e llogarisë në “BKT” të znj. S. R., rezultoi se në datë 13.1.2017 është transferuar shuma 87 000 euro nga noteri që ka hartuar kontratën e shitblerjes.

**33.2** Në po të njëjtën datë është tërhequr shuma 14, 000 euro me emërtim tërheq nga llogaria për mbyllje kredie, e cila siç rezultoi nga deklaratimet e djalit të subjektit në DVP/2017 është përdorur për shlyerjen e kredisë në “Credins Bank”.

**34.** Nga ana e ZVRPP-së Tiranë informohemi se:

**34.1** Djali i subjektit, z. B. D., ka në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij, një apartament në rrugën “\*\*\*\*” me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>. Ky apartament është blerë në datën 22.2.2017 me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*. Çmimi i apartamentit është 70 000 euro.

**34.1.1** PAGESA e këtij apartamenti vërtetohet me 2 mandatarkëtimin të datës 27.2.2017 të “BKT”-së, nga ku rezultoi se djali i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë transferuar secili nga 35.000 euro në llogari të noterit që ka hartuar kontratën e shitblerjes. Këto veprime konfirmohen dhe nga nxjerrja e llogarive të z. B. D., dhe znj. S. R.

**34.1.2** Në lidhje me burimin e këtij apartamenti në DVP/2017, z. B. D., deklaroi se janë të ardhurat e përfituara nga shitja e truallit në Rrugën e Elbasanit në pronësi të znj. S. R., dhe

---

nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2019; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2019; Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2019.

familjarëve të saj. Ai deklaron se bashkëshortja i ka dhuruar 35 000 euro nga shuma e shitjes së truallit, të cilat janë përdorur më pas për blerjen e apartamentit.

**34.1.3** Nga nxjerrja e llogarisë në “BKT” të z. B. D., rezulton se në datën 24.2.2017 znj. S. R., i ka transferuar shumën 35 000 euro, duke cituar kontratë dhurimi nr. \*\*\* datë 20.2.2017.

**34.2** Bashkëshortja e djalit të subjektit ka në pronësi:

(i) Pasuria nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, apartament me sipërfaqe 103 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi. Znj. S. R., ka 1/6 pjesë takuese.

**34.2.1** Kjo pasuri e ka origjinën nga dëshmia e trashigimisë nr. \*\*\* datë 9.1.2015.

(ii) Pasuria nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, njësi me sipërfaqe 33.9 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi.

**34.2.2** Kjo pasuri është përfituar me Leje Legalizimi nr. \*\*\*, datë 18.7.2018, ku përfituese janë A. R., S. R., dhe A. R. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore 16.8 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e ndërtimit 33.9 m<sup>2</sup>.

**35.** Në DVP/2017 djali i subjektit deklaron se i ka marrë hua z. B. Q., shumën 26 300 euro për mobilimin e shtëpisë.

**35.1** I është kërkuar subjektit dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e z. B. Q.

**35.2** Nga ana e subjektit është depozituar vërtetim page për z. B. Q., lëshuar në datë 26.12.2019 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2009-2019, nga ku rezulton se z. Q., ka përfituar të ardhura në total në shumën 10 538 520 lekë.

**36.** Nga analiza financiare ndër vite nuk rezultojnë mungesa të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve të kryera.

#### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**37.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**37.1** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përprjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**37.2** Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

**37.3** Subjekti rezulton me një bilanc negativ në vitin 2008 në shumën 358 816 lekë, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e tyre në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në vitin 2008 nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**37.4** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**38.** Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**39.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit raportin<sup>23</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, ku ka konstatuar se, (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në Deklaratën për Kontrollin e Figurës si dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**39.1** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**39.2** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjensitë ligjzbatuese apo fakteve të dala gjatë hetimit.

**40.** Gjatë hetimit administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*“Nga muaji shtator i vitit 2002 deri në qeshor 2003 kam qëndruar në banesën në pronësi të z.N. Gj...Shtetasi N. Gj., është i zonës time dhe kemi njohje familjare të hershme dhe më ka ofruar ndihmën e tij vetëm për këtë shkak. Në dispozicion ju vë deklaratën nga ana e bashkëshortes së tij.”*

**40.1** Për të vërtetuar deklarin e tij subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën e bashkëshortes së z. N. Gj., znj. D. Gj., të datës 18.11.2019, e cila deklaroi se: *“Së bashku me bashkëshortin kam një shtëpi banimi dykatëshe me çati plus papafingo në L.\*\*\*, \*\*\*, Durrës. Në periudhën shtator 2002 - qershor 2003, katin e dytë ia kemi lënë në përdorim pa kundërshpërblim shtetasit Ludovik Dodaj. Ky person është i njohur i familjes tonë...”*

**40.2** Nga hetimi administrativ në lidhje me z. N. Gj., referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 17.07.2018 të KPK-së dhe vendimit nr. \*\*\* (JR) datë 22.11.2018 të KPA-së, rezulton se:

*“Për shtetasin N. Gj., ka filluar procedimi penal me nr. \*\*\* të vitit 2011, për veprën penale të parashikuar në nenin 283 të K.Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, procedim i cili është pushuar në datën 20.3.2012 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndërkohë, në po të njëjtën datë (20.03.2012) organi i akuzës, ka pezulluar hetimin për të njëjtin procedim penal, atë me numër \*\*\* të vitit 2011, për shkak se nuk janë gjetur autorët e veprës penale. Si rrjedhim, duke qenë se shtetasi N. Gj., është proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i K. Penal, hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar, parashikuar nga pika 15 e ligjit nr. 84/2016.”*

<sup>23</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZh-së, nr. \*\*\*, datë 11.9.2019)

**40.3** Nga ana e subjektit është deklarur gjatë hetimit administrativ se me shtetasin N. Gj., ka njohje familjare të hershme si dhe ai i ka ofruar ndihmë për shkak të kësaj marrëdhënie, duke i dhënë në përdorim banesën e tij pa kundërshpërblim.

**40.4** Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës se ka patur njohje me shtetasin N. Gj., i cili është person që është proceduar për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

**40.5** Komisioni hetoi në lidhje me kontaktin e subjektit me këtë shtetas. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk ka kontakt me këtë shtetas pas vitit 2006, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

**41.** Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se: *“Nga qeshori i vitit 2003 deri në nëntorin e vitit 2006 kam banuar në shtëpinë e z. Ll. K., e regjistruar në zonën kadastrale \*\*\* me numër pasurie \*\*\*, apartament, në lagjen nr.\*\*\*, rruga “\*\*\*\*” Durrës. Në këtë banesë kam qëndruar pa kundërshpërblim, pasi me këtë person kishim njohje familjare dhe duke ditur pamundësinë time për të blerë menjëherë shtëpi në Durrës më ka mundësuar të strehohem me familjen deri në momentin që unë do të bleja apartamentin tim.”*

**41.1** Për të vërtetuar deklarin e tij, subjekti ka vënë në dispozicion:

(i) Deklaratën e z. Ll. K., të datës 18.11.2019, i cili deklaroi se:

*“Unë kam qenë pronar i pasurisë me nr.\*\*\*...Në periudhën kohore qershor 2003-nëntor 2006 këtë shtëpi ia kam lënë në përdorim pa kundërshpërblim shtetasit Ludovik Dodaj...”*

(ii) Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë “apartament”, në pronësi të z. Ll. K., me sipërfaqe 154 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\* dhe adresë “\*\*\*\*” lagjja nr. \*\*\*.

**41.2** Nga ana e subjektit është deklarur gjatë hetimit administrativ se me shtetasin Ll. K., ka njohje familjare, duke i dhënë strehim pa kundërshpërblim.

**41.3** Nga hetimi administrativ, bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2019, të Gjykatës së Lartë, rezultoi se:

(i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.\*\*\*, datë 2.10.2009 ka vendosur:

*“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ll. K., për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe në bazë të nenit 248 e 49 të Kodit Penal e dënon me 19 muaj burgim e 400 mijë lekë gjobë. Pushimin e çështjes penale për të pandehurin Ll. K., për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, në zbatim të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale.*

*I pandehuri Ll. K., ka qëndruar në dhomat e paraburgimit me masën e sigurimit “Arrest në burg”, nga data 11.3.2008 deri më 1.4.2008 dhe më pas kësaj datë është me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”.*

*Gjyba të paguhet në katër këste brenda një viti nga marrja formë të prerë të vendimit.”*

(ii) Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.\*\*\*, datë 16.11.2011, ka vendosur:

*“Lënien në fuqi të vendimit nr.\*\*\*, datë 2.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me të pandehurin Ll. K.”*

**41.4** Në pjesën “rrethanat e faktit” Gjykata argumenton se:

*“Në datën 7.9.2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka filluar procedimin penal nr.\*\*\*, për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” e “Falsifikimit të dokumenteve” sipas neneve 248, 258 e 186/2 të Kodit Penal në ngarkim të të gjykuarve Ll. K., D. L., P. M., P. B., D. A., B. T., M. P., e S. S”.*



**41.5** Bazuar në nenin 3/1/d të ligjit 10192, datë 1.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar, vepra penale e parashikuar nga neni 258 i K.Penal është e përfshirë në fushën e zbatimit të këtij ligji.

**41.6** Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës se ka patur njohje me shtetasin Ll. K., i cili është person që është proceduar për veprën penale të parashikuar nga neni 258 i K.Penal.

**41.7** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti nuk ka kontakt me këtë shtetas pas vitit 2006, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

**42.** Në deklaratën e kontrollit të figurës subjekti ka deklaruar së djali i motrës së tij z. K. P., rezulton i dënuar në Itali për "mbajtje lënde narkotike".

**43.** Nga hetimit nuk konstatohet se subjektit ka patur kontakte me shtetasin K. P., në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**44.** Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues, që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet që ai gjithnjë duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

**45.** Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

**46.** Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë Deklaratën e Kontrollit të Figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se, subjekti i rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës "b", të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

#### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

**47.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**47.1** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të

dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**47.2** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

### **47.3** Të dhëna nga burime arkivore

**47.3.1** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se, për subjektin e rivlerësimit Ludovik Dodaj (i) nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale); (ii) nuk ka pasur ndaj tij, materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara apo pezulluara; (iii) Sektori Protokoll – Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2019, bën me dije se, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit.

**47.3.2** Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2018, rezulton se ka një ankesë: praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2015, në lidhje me ankesën e shtetasit V. V., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit L. D.

**47.3.2.1** Me anë të ankesës, shtetasi V. V., pretendon se në gjykimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës, prokurori i seancës Ludovik Dodaj ka shkëlur dispozitat procedurale, dhe për këtë shkak i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm zëvendësimin e prokurorit Ludovik Dodaj.

**47.3.2.2** Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria Task Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga ky sektor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2016 i është kthyer përgjigje ankuesit. Meqenëse çështja penale është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës, bazuar në nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale, ankuesit i është sugjeruar se pretendimet lidhur me përjashtimin e prokurorit duhet t'i paraqesë pranë Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës.

**48.** Analiza e gjetjeve: analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (1) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (2) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

#### **i.** Aftësitë profesionale

**48.1** Njohuritë ligjore: Referuar raportit konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti i rivlerësimit analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore. Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi elementëve të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Subjekti sjell në

vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë për interpretimin e instituteve ligjore. Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.

**48.2** Arsyetimi ligjor: Nga vëzhgimi i akteve të sipërpërshkruara arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

ii. Aftësitë organizative

**48.3** Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv. Në efektivitetin dhe eficientësinë e veprimtarisë së tij nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë normale. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

**48.4** Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: Subjekti i rivlerësimit merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Konstatohet se është i aftë profesionalisht në këtë pjesëmarrje dhe për qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

**48.5** Aftësia për të administruar dosjet: Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike. Në përgjithësi, aktet na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, si dhe disponimin e gjykatave.

iii. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

**48.6** Etika në punë: Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë vërehet se, nga ana e subjektit të rivlerësimit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

**48.7** Integriteti: Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

**48.8** Paanësia: Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

iv. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

**48.9** Aftësitë e komunikimit: Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

**48.10** Aftësia për të bashkëpunuar: Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

**48.11** Gatishmëria për t'u angazhuar: Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ludovik Dodaj, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, prokurori deklaron se është angazhuar në 3 (tri) aktivitete trajnuese të llojit seminar. Lidhur me trajnime të tjera, të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar të ketë qenë pjesëmarrës në aktivitete të tilla.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

**49.** Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLP-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

**49.1** Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavaruar 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**49.2** Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

### **❖ Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit**

**50.** Për subjektin e rivlerësimit Ludovik Dodaj janë administruar katër denoncime të paraqitura pranë KPK-së, përkatësisht nga shtetasit R.R., V.Ç., N.Z. dhe K.K.

**50.1** Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, për shkak të këtyre denoncimeve, rezulton se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**51.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

**51.1** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

**51.2** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në praninë *online* edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, referuar në nenin 4 pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ludovik Dodaj.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 8.6.2020

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela ZHEGU**  
Kryesues

**Olsi KOMICI**  
Anëtar

**Genta Tafa (BUNGO)**  
Relatore

**Sekretare gjyqësore**  
**Fiorela MANDRO**

